



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

BULETINI Tetor – Dhjetor 2024



Përmes këtij buletini pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për periudhën kohore Tetor-Dhjetor 2024

Aktakuzë kundër dy personave për veprat penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe dhënia e ryshfetit



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË



Aktakuzë kundër dy personave për veprat penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe dhënia e ryshfetit

Gjakovë, 2 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit T.Gj., për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par.1 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin B.K., për veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri i parë T.Gj., nga data 07.02.2024, deri me dt.23.02.2024, në cilësinë e personit zyrtar në Njësinë Regjionale të Komunikacionit Rrugor në Gjakovë, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar tejkalon kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ka dëmtuar personin tjetër, ku ka komunikuar me telefon dhe është takuar me tani të pandehurin B.K., ashtu që ka plotësuar gjobat e trafikut nga data 09.02.2024, të fotokopjuara më parë, me numër shq., të shqiptuar në emër të V.B., dhe me dt.21.02.2024, ka plotësuar gjobën me numër shq., të shqiptuar në emër të A.B., bazuar në kërkesën e tani të pandehurit B.K., në atë mënyrë gjobat i ka fotografuar dhe ia ka dërguar të njëjtit në viber me qëllim që nga B.K., të përfitoj ku me datë 23.02.2024, rreth orës 15:38 min, vjen me automjetin të tipit WV Passat dhe pjesët për servisim të automjetit në vlerë

112 Euro, i merr tek një pompë e derivateve në Gjakovë, ku i pandehuri B.K., ja len punëtorit të pompës së derivateve për t'ia dorëzuar të njëjtit, ashtu që pas njoftimit të IPK-së, me rastin ka rezultuar se gjobat nuk i kishte dorëzuar në Stacionin Policor, i pandehuri dhe as nuk i kishte plotësuar në librin e tiketave por që të njëjtat i kishte përdorur në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 par.1 të KPRK-së.

Po ashtu në pikën e dytë të dispozitivit të aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri i dytë B.K., me datë 23.02.2024, me qëllim të dëmtimit të qytetarit – ish shokut të tij V.B., në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të personit zyrtar që të veprojë në kuadër të detyrës zyrtare i kërkon të pandehurit T.Gj., që në cilësi të zyrtarit policor të Komunikacionit Rrugor, ta dënoj V.B., dhe familjen e tij sa herë të i takojë, ashtu që i pandehuri B.K., pasi është njoftuar nga i pandehuri T.Gj. me tiketën, me numër shq., të shqiptuar në emër të V.B., dhe tiketën me numër shq., të shqiptuar në emër të A.B., që ja ka fotografuar i pandehuri T.Gj., ditën kritike rreth orës 15:33 min, vjen me automjet kombi ngjyrë e bardhë dhe i sjell tek një pompë e derivateve në Gjakovë, pjesët për servisim të veturës së tij në vlerë prej 112 Euro, të cilat ia kishte dhënë punëtorit të pompës së derivateve, duke ia bërë të ditur se do të vij zyrtari policor T.Gj.,.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Bashkëpunimi Ndërinstitucional për Rikthimin e Aseteve të Përfituara nga Krimi



Gjakovë, 4 tetor 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Z. Enis Gashi, së bashku me prokurorët e kësaj prokurorie, pritën sot në një takim të rëndësishëm Prokurorin nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, z. Bahri Hyseni, Udhëheqës i Zyrës për Rikthimin e Aseteve, përfaqësuesin nga Ambasada Amerikane në Kosovë, si dhe përfaqësues të institucioneve kyçe për rikthimin e asetëve të përfituara përmes veprave penale, si Agjencia për Inteligjencë Financiare, Ministria e Drejtësisë, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Gjatë takimit, nga të gjithë prokurorët dhe pranishmit është diskutuar dhe shkëmbyer mendime mbi përmirësimin e procedurave dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, ku në këtë drejtim ishte gjurmim, ngrirja dhe sekuestrimi i asetëve të përfituara përmes veprave penale, si dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar për rritjen e efektivitetit në këtë proces, u konsiderua kyç për suksesin e këtyre përpjekjeve, duke ndihmuar në kthimin e asetëve të paligjshme dhe zbardhjen e rasteve të rëndësishme kriminale.

Kryeprokurori, Z. Enis Gashi, së bashku me prokurorët e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, falënderuan pjesëmarrësit për vizitën e tyre duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me këto institucione për të arritur rezultate sa më të mira.

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË




Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge

Gjakovë, 08 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet E.Ll., ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve si dhe ka paraqitur, kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet E.Ll., Më datë 07.10.2024, rreth orës 15:00 në Gjakovë, respektivisht në shtëpinë e tij, pa autorizim dhe me qëllim të shitjes apo shpërndarjes ka poseduar substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, substanca psikotrope ose analoge, në atë mënyrë që DHTN pas marrjes së informatës për të pandehurin dhe më pas nga bastisja dhe kontrolli brenda në shtëpinë e tij janë gjetur dhe sekuestruar një (1) qese plastike me substancë narkotike në formë bari në peshë prej 0.9 gr, njëzet e shtatë (27) qese plastike me substancë narkotike në formë bari në peshë prej 34 gram, shtatëdhjetë (70) qese plastike me substancë narkotike në formë bari në peshë prej 100 gram, një (1) qese plastike me substancë narkotike në peshë prej 534 gram të gjitha të dyshuara për narkotik të llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 668.9 gram, si dhe të holla në vlerë prej 500 euro, një (1) telefon dhe një (1)



peshore digjitale, të gjitha të sekuestruar në vendin e ngjarjes, respektivisht në shtëpinë e të pandehurit nga hetuesit policor, dhe me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së.

Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjakovë



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

Përmbledhje e punës javore 7-13 TETOR 2024

- Dymbëdhjetë (12) aktakuza, ndaj (12) personave,
- Pesëmbëdhjetë (15) persona të ndaluar,
- Katër (4) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj pesë (5) personave,
- Pesë (5) kërkesa për sekustrim,
- Dy (2) lëndë të zgjidhura përmes procedurës alternative të ndërmjetësimit, me katër (4) persona.



Gjakovë, 14 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në periudhën 07 tetor – 13 tetor 2024, janë proceduar :

Dymbëdhjetë (12) aktakuza, ndaj (12) personave,

Pesëmbëdhjetë (15) persona të ndaluar,

Katër (4) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj pesë (5) personave,

Pesë (5) kërkesa për sekuestrim,

Dy (2) lëndë të zgjidhura përmes procedurës alternative të ndërmjetësimit, me katër (4) persona.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, mbetet e angazhuar për të siguruar drejtësi dhe për të ndjekur penalisht të gjithë ata që shkelin ligjin, duke vazhduar me përkushtim në misionin e saj për të mbrojtur qytetarët dhe të drejtat e tyre.

Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë muajit tetor 2024 ka ngritur 20 aktakuza për dhunën në familje



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË/ OSNOVNO TUŽILAŠTVO DJAKOVICA/
BASIC PROSECUTION IN GJAKOVA

DHUNA NË FAMILJE

1-31 TETOR 2024

20 Aktakuza, kundër 24 personave

4 Kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj 4 personave



Gjakovë, 4 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, gjatë muajit tetor 2024, ka ngritur njëzet (20) aktakuza, kundër njëzet e katër (24) personave, si dhe ka paraqitur katër (4) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj katër (4) personave, për veprën penale “Dhuna në familje”.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, mbetet e angazhuar për të siguruar drejtësi dhe për të ndjekur penalisht të gjithë ata që shkelin ligjin, duke vazhduar me përkushtim në misionin e saj për të mbrojtur qytetarët dhe të drejtat e tyre.

Gjithashtu, kjo prokurori, është e angazhuar që të kryejë me seriozitet të lartë të gjitha rastet, e me prioritet të veçantë ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Aktakuzë kundër një personi për veprën penale trafikimi me njerëz



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË/ OSNOVNO TUŽILAŠTVO
DJAKOVICA/ BASIC PROSECUTION IN GJAKOVA

**Aktakuzë kundër një personi për
vepren penale trafikimi me njerëz**



Gjakovë, 4 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit A.P., për veprën penale “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 par.1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri A.P., nga muaji marsi i vitit 2021, e deri me datë 30.01.2024, në Gjakovë, merr pjesë në trafikimin me njerëz me anë të kanosjes, përdorimit të forcës, mënyrës së përfitimit përmes punës së detyruar dhe veprime të tjera të dhunshme, kontrolluese të përcjella me maltretimin fizik dhe psikik me qëllim shfrytëzimi për përfitim ndaj të dëmtuarës A.V.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kryeprokurori z.Enis Gashi, priti në takim Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike



Gjakovë, 14 nëntor 2024

Në kuadër të aktiviteteve të Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, kryesuesi i këtij komisioni z. Arian Gashi, së bashku me anëtarët e tjerë, znj. Laura Pula dhe z. Arben Ismajli, vizituan Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Gjatë këtij takimi është diskutuar Raporti për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-tetor të vitit 2024, si dhe sfidat e ndryshme në trajtimin e tyre gjatë procesit të punës, me ç'rast anëtarët e Komisionit u informuan në detaje nga Kryeprokurori Gashi.

Anëtarët e Komisionit dhe Kryeprokuror z.Gashi, u pajtuan që të vazhdojnë trajtimin me prioritet të lëndëve të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Aktakuzë kundër një personi për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**



Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

**PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË/ OSNOVNO TUŽILAŠTVO DJAKOVICA/
BASIC PROSECUTION IN GJAKOVA**

Aktakuzë kundër një personi për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge

Gjakovë, 3 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit E.Ll., për veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga nenit 267, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, ndër të tjera, cekët se i pandehuri E.Ll., më parë e gjer më datë 07.10.2024, rreth orës 15:00 në Gjakovë, pa autorizim dhe me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ka poseduar substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, substanca psikotrope ose analoge.

Gjatë bastisjes së shtëpisë së tij, nga ana e zyrtarëve policorë, janë gjetur dhe sekuestruar 99 (nëntëdhjetë e nëntë) qese plastike me substancë narkotike të llojit Kanabis (Marihuanë), që përmban THC, me peshë neto të përgjithshme prej 601.87 ± 0.0001 gram, si dhe një peshore digjitale, të gjitha të sekuestruara në vendin e ngjarjes nga hetuesit policorë.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokuroria e Gjakovës për një muaj ka ngritur 118 aktakuza



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor


PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË/ OSNOVNO TUŽILAŠTVO DJAKOVICA/
BASIC PROSECUTION IN GJAKOVA

**Prokuroria e Gjakovës për një muaj ka
ngritur 118 aktakuza**

118 Aktakuza, kundër 137 personave

Dhuna në familje

15 Aktakuza, kundër 17 personave



Gjakovë, 10 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur njëqind e tetëmbëdhjetë (118) aktakuza, kundër njëqind e tridhjetë e shtatë (137) personave, për vepra të ndryshme penale gjatë muajit nëntor 2024, duke përfshirë pesëmbëdhjetë (15) aktakuza, kundër shtatëmbëdhjetë (17) personave, për veprën penale “Dhuna në familje”.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, mbetet e përkushtuar në luftimin e kriminalitetit, ngritjes së efikasitetit në punë, transparencës e llogaridhënies.

Gjithashtu, kjo prokurori, është e angazhuar që të kryejë me seriozitet të lartë të gjitha rastet, e me prioritet të veçantë ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprat penale fajdeja dhe kanosja



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË/ OSNOVNO TUŽILAŠTVO DJAKOVICA/
BASIC PROSECUTION IN GJAKOVA

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprat penale fajdeja dhe kanosja

Gjakovë, 13 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet N.H., ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve si dhe ka paraqitur, kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet N.H., nga viti 2022 e tutje, me qellim të përfitimit për vete kontraktonte një shumë dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër dhe atë të dëmtuarit A.H., duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të këtij të fundit, e ku deri më tani gjithsej ka dhënë pasurinë në vlerë prej 44.000 mijë euro, ndërsa tani i pandehuri është duke i kërkuar 52.000€, edhe pse deri më tani në emër të kamatës ka paguar 17.950€ të cilat është obliguar që ta marrë kredi në bankë ku ka vendosur edhe shtëpinë në hipotekë.

I pandehuri është arrestuar në flagrance nga ana e Policisë së Kosovës, duke pranuar të holla nga viktima në emër të kamatave të paligjshme me të cilat e kishte ngarkuar të njëjtin.

Gjithashtu që nga viti 2023, në vazhdimësi, me fjalë dhe veprime, seriozisht e kanos personit tjetër se do ta privoj nga jeta dhe atë të dëmtuarin A.H., në atë mënyrë që, pasi ky i fundit kishte marrë para me fajde nga i pandehuri N.H.,

Këto veprime formojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, “Fajdeja” nga neni 331 par. 2, lidhur me par.1, të KPRK-së, dhe veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par.2, të KPRK-së.

Aktakuzë kundër dy personave për veprën penale vrasja e rëndë në bashkëkryerje dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve



Gjakovë, 19 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit Gj.Gj., dhe Z.A., për shkak të veprës penale “Vrasja e rëndë në bashkëkryerje”, nga neni 173 par.1, pika 1.11, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se të pandehurit Gj.Gj., dhe Z.A., me dt.25.06.2023, në f.sh.”M...” – K.Gjakovë, duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje privojnë nga jeta tani të

ndjerët B.I., dhe H.I., ku në ditën kritike dy të pandehurit takohen me viktimat në rr.”Q...” në f.sh.”M...”, dhe në fjalosje e sipër të pandehurit kanë shtënë me armë zjarri disa herë në drejtim të viktimave, ku si pasojë ndërrojnë jetë viktimat B.I., dhe H.I.

Me këto veprime të pandehurit kanë kryer veprën penale “Vrasja e rëndë në bashkëkryerje”, nga neni 173 par.1, pika 1.11, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Po ashtu në pikën e dytë të dispozitivit të aktakuzës, dy të pandehurit Gj.Gj., dhe Z.A., secili veç e veç kanë kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Ndalohen dy persona për 48 orë



Gjakovë, 20 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton se me vendim të Prokurorit të Shtetit, ka ndaluar për 48 orë të dyshuarin P.B., për shkak të dyshimit të bazuar se sot me dt.20.12.2024, në f.sh.B... – K.Gjakovë, për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme, ka tentuar të privoj nga jeta, duke shtënë në drejtim të viktimës Gj.B., me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale “Vrasja në tentativë”.

Po ashtu, lidhur me këtë rast nga Departamenti i Përgjithshëm, është ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh, edhe personi tjetër i dyshuar me initiale Z.B, në datën dhe në vendin e njëjti pasi që zyrtaret policor kanë shkuar në shtëpinë e të dyshuarit për bastisje, i dyshuari ka sulmuar njërin prej zyrtarëve policor, me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “Sulmi ndaj personit zyrtar” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokuroria Themelore në Gjakovë, njofton se ndaj të dyshuarve P.B., dhe Z.B., brenda afatit ligjor, do të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën kompetente.


Aktakuzë kundër një personi për shkak të veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur



Gjakovë, 23 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit Y.A., për shkak të veprës penale “Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”, nga neni 371, paragraf.4, lidhur me paragraf.3, dhe 1, të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri Y.A., me dt.24.08.2024, në Rr.”N...” në f.sh.Korishë – K.Prizren, ka drejtuar automjetin e tipit VW pasat, në ndikim të alokoolit, në këtë mënyrë i pandehuri ka ngasë automjetin në kundërshtim me Rregullat e Trafikut Rrugor,



ku ka rrezikuar jetën e pjesëmarrësve në komunikacion, në atë mënyrë duke mos përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit me kushtet e rrugës dhe gjendjes së tij, me anësoren e parë të automjetit i godet dy të miturit të cilit ishin në një biçikletë, në atë mënyrë nga inercioni i goditjes pësojnë lëndime dy të miturit, ku njëri prej të miturve nga lëndimet e marra, ndërron jetë, ndërsa i mituri tjetër pëson lëndime të rënda trupor.

Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale “Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”, nga neni 371, paragraf.4, lidhur me paragraf.3, dhe 1, të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.